

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj kryetare, Have Haliti dhe Driton Muharremi, me bashkëpunëtorin profesional Perparim Zeka, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit av. R.L. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- DKR në Gjilan PKR.nr.249/2016 të dt. 12.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 të KPPK-së, më datën 15.12.2017, mori këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore- DKR në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan PKR.nr.249/2016, i dates 12.09.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.249/2016 të dt. 12.09.2017, i akuzuari A.S., është liruar nga akuza, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPK-së, meqë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore-DKR, në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigjeje në ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit A.S., av. R.L., me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore –DKR në Gjilan, të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.479/17 të dt. 02.11.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, aktgjykimi, i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim, ndërsa përgjigja në ankesën e parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, meqenëse i akuzuari është liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit dhe gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan , është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Aktgjykimi është përpiluar në harmoni me dispozitat ligjore, gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar çdo provë veç e veç, e pastaj të gjitha së bashku dhe ka dhënë arsye pse në veprimet e të akuzuarit nuk ekzistojnë elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës dhe nuk ekziston përgjegjësia penale e të akuzuarit për veprën për të cilat është akuzuar.

Prokuroria në ankesë pretendon se, me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar të gjitha provat të cilat qartë dëshmojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, se i dëmtuari G.E., i ka sqaruar rrethanat e ngjarjes së ditën kritike, i akuzuari ka shkuar me veturë në drejtim të tij për të goditur, por ka arritur të largohet, në këtë rast e ka gjuajtur të akuzuarin me guri dhe e ka goditur shofershajben e veturës, ku i akuzuari e ka humbur drejtimin dhe e ka goditur një veturë tjetër dhe murin e një oborri, se mos të ishte larguar i dëmtuari ishte goditur nga vetura e të akuzuarit, gjë që gjykata gabimisht e ka vlerësuar se nuk ka pasur dashje i akuzuari për kryerjen e veprës penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet ankimore të Prokurorisë nuk janë të bazuara, gjykata e shkallës së parë, i ka administruar të gjitha provat, ka dëgjuar të

dëmtuarin G.E., dëshmitarin E.S. dhe të akuzuarin. I dëmtuari G.E. ka deklaruar se më herët kanë pasur mosmarrëveshje me disa shokë të akuzuarit, ditën kritike një shok i A. me emrin G.L. dhe N.L., i kanë dërguar mesazh në telefon dhe i kanë thënë prit të shtëpia se jemi duke ardhur dhe kanë sharë, para shtëpisë së tij ka qenë me E.S. dhe një shok të tij me emrin Z., i akuzuari A. ka qenë me veturë, ai dhe me shokët e tij G. dhe N. janë ndalur të shtëpia e tij, kanë dalë nga vetura, i kanë nxjerrë thikat, kurse për tu mbrojtur ka hyrë në oborrin e tij ka marrë një sëpatë dhe i ka ndjek, ata kanë hyrë në veturë dhe janë ikur, i akuzuari A. me veturë ka shkuar në drejtim të tij për të goditur, por ka arritur të largohet, në këtë rast e ka gjuajtur të akuzuarin me guri dhe e ka goditur shofershajben e veturës, i akuzuari e ka humbur drejtimin dhe e ka goditur një veturë tjetër, se mos të ishte larguar i dëmtuari ishte goditur nga vetura e të akuzuarit, se me të akuzuarin A. më parë nuk ka pasur problem por me shokët e tij. Kurse dëshmitari E.S. ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë së bashku me G.E. te shtëpia e tij duke qëndruar në rrugë, ka dëgjuar se Ga. është sharë me dikën në telefon, pas 10 minutave ka ardhur një veturë me 3-4 veta, është ndalë para dyerve të Ga. dhe nga vetura kanë dalë të gjithë përveç shoferit, personat që kanë dalë nga vetura njëri prej tyre ka qenë me emrin G. e tjetri N., ju kanë vërsulur me thika Ga. ndërsa vozitësi ka qenë në veturë, e që më vonë e ka identifikuar se ka qenë A.S., ai ka filluar me ik por disa kushëri të Ga. e kanë gjuajtur me tulla, shoferi e ka humbur drejtimin dhe e ka goditur duvarin, sipas këtij dëshmitari i akuzuari A. nuk e ka rrezikuar askënd dhe nuk ka tentuar të shkel askënd.

Kjo gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ia ka falur besimin dëshmisë së dëshmitarit E.S., për shkak se dëshmitari E.S. është shok i të dëmtuarit G.E. dhe nuk ka asnjë arsye që të flas diçka që nuk është e vërtetë e që shkon në favor të akuzuarit, ndërsa sa i përket dëshmisë së të dëmtuarit G.E., ajo është kontradiktore me dëshminë e dëshmitarit E.S., të cilin i dëmtuari e ka pasur shok dhe ka qenë dëshmitar okular, se nuk është vërtetuar me ndonjë provë tjetër se i akuzuari A., ka dashur dhe ka pasur për qëllim ta godas me veturë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, provat në bazë të cilave është ngritë aktakuza janë vetëm supozime, se i akuzuari ne vendin e ngjarjes ka tentuar te privojë nga jeta te dëmtuarin G.E., se prokuroria nuk ka afruar prova tjera përveç dëshmisë se të dëmtuarit Ga. e cila është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit okular E.S., i cili ka qenë në vendin e ngjarjes dhe është shok i të dëmtuarit. Nuk është detyrë e të akuzuarit të vërtetojë pafajësinë e tij, por është detyrë e prokurorit të vërtetojë akuzën me prova konkrete e qe në rastin konkret Prokurori nuk ka arritur ta bëjë një gjë të tillë.

Meqë aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nga kjo rezulton se edhe ligji penal është aplikuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, kur në mungesë të provave të akuzuarin e ka liruar nga akuzat, për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK.

Gjykata e Apelit, vlerëson se në rastin konkret pas procedimit të provave të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, dhe marrjes në pyetje të dëmtuarit dhe dëshmitarit, me asnjë provë nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale e cila i vihen në barrë sipas aktakuzës, prandaj, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar ligjin penal kur të akuzuarin e ka

liruar nga akuza, për arsyet e cekura më lartë, ankesa e prokurorisë nuk është e bazuar, kurse përgjigja e mbrojtësit të akuzuarit në ankesë, është e bazuar.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APLEIT E KOSOVËS
PAKR.nr. 510/17 i datës 15.12.2017

Procesmbajtësi

Anëtarët e kolegjit;

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj

Përparim Zeka

1. Have Haliti _____

2. Driton Muharremi _____